



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. _____ Prot.

Tiranë më ____ . ____ . _____

PROCES- VERBAL
Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile

Më datë 7 shtator 2017, ora 11:00, pranë ambjenteve të AMShC-së nis takimi i anëtarëve të shoqërisë civile të KKSHC-së. Të pranishëm janë:

Për KKShC-në:

Z. Vladimir THANO;
Z. Ali COKA;
Z. Ergys GEZKA;
Z. Blendi DIBRA;
Znj. Emanuela ZAIMI;
Znj. Zana VOKOPOLA;

Për AMShC-në:

Z. Erion BANUSHI;
Z. Andi LUGA;
Znj. Ina GJINI;
Z. Ferhat AGA;

Fjalën e hapjes e mori z. Banushi ku parashtrroi pikat e diskutimit në këtë takim.

Ai shprehu domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit të KKSHC-së në përputhje me ndryshimet e reja të Qeverisë. Më pas njoftoi mbi takimin që do të zhvillohet javën e ardhshme në Kryeministri me përfaqësuesit e KKSHC-së nga institucionet qendrore.

Znj. Vokopola u shpreh se ndryshimet në strukturën qeveritare sjell ndryshimin e Nenit 5 të Ligjit për KKSHC-në. Duke sjellë kështu edhe ndryshimet përkatëse për secilin përfaqësues të Ministrisë.

Për efekt lehtësie propozoi që këto ndryshime të bëhen me VKM.

Z. Aga u shpreh se ky ndryshim nuk mund të ndodhë me VKM, por duhet me patjetër të realizohet me Ligj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Z. Coka i sugjeroi z. Banushi se nevojitet një Zv./Minister për fushën e agrikulturës.

Z. Banushi iu drejtua z. Aga dhe znj. Gjini për të shpjeguar ndryshimet në Rregulloren e KKSHC-së.

Z. Aga dhe znj. Gjini u shprehën se ndryshimet në Rregullore janë të natyrës procedurale dhe integrimin e masave disiplinore si parandaluese për disiplinimin e sjelljes së anëtarëve të Këshillit.

Z. Gezka u shpreh dakord në parim me ndryshimet në Rregullore.

Z. Dibra kërkoi sqarim mbi mënyrën se si do të mbulohen shpenzimet. Z. Thanu ndërhyu dhe shprehet se takimet e KKSHC-së janë vullnetare. Në vijim z. Banushi plotësoi se AMSHC do të kërkojë buxhet shtesë për shpenzimet e Këshillit si edhe shtoi se BE ka vendosur të asistojë financiarisht në “facility building”.

Znj. Zaimi shprehu ankesën për varësinë nga institucionet qendrore. Ajo theksoi kohën e gjatë të humbur duke u marrë me ndryshimet në Rregullore dhe në këtë situatë u shpreh se është e gatshme të japë dorëheqje pasi ka patur pritshmëri më të mëdha për Këshillin.

Znj. Vokopola u shpreh se ndarja e komiteteve sipas Rregullore bazuar në fushat e Ligjit duket në rregull.

Z. Thanu propozoi të mblidhen diku për pesë ditë në mënyrë që të finalizojnë Rregulloren. Pas disa diskutimesh anëtarët ranë dakord.

Znj. Vokopola u shpreh nëse është e mundur të thërrasë përfaqësues nga Qeveria kur të mbledhë palët e interesit. Z. Gezka u shpreh se problemet e saj mund t’ia paraqesë Qeverisë me relacion.

Znj. Zaimi pyeti mbi mënyrën e komunikimit dhe kush mund të shprehet në emër të Këshillit.

Z. Gezka pyeti nëse mund të bëjmë shkëmbime eksperiencash me Kroacinë, ku do t’u duhej të mblidhen për tre apo pesë ditë dhe AMSHC të thërrasë ekspertë për hartimin e strategjisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Z. Coka sugjeroi që Kryetari i KKSHC-së të zgjidhet nga Kryeministri dhe të organizohen aktivitete në kuadër të Ditës Botërore të Alzheimerit.

Znj. Zaimi propozoi që të diskutohet në mbledhjen e ardhshme edhe shtimi i Fondit Social, i cili është i nevojshëm referuar edhe sugjerimeve nga ndërkombëtarët.

Z. Banushi u shpreh që në mbledhjen e ardhshme që të gjithë anëtarët të vijnë me propozime konkrete në mënyrë që të ketë hapësirë diskutimi.

Mbledhja u mbyll në orën 12:30.